

Nxënësit e Gjimnazit Hasan Nahi, Lendrit Januzaj dhe Endrit Himaj janë dy “shkencëtarët”

kosovarë që kanë marrë medaljen bronzë (çmimin e tretë) në Olimpiadën Ndërkombëtare “I

SWEEP-2014”, në fushën e projekteve mjedisore për energji të qëndrueshme.

Kjo olimpiadë u organizua në datat 30 Prill-5 Maj në Hjuston, Teksas, të Shteteve të Bashkuara

të Amerikës. “Kanceri në paratë e letrës. Zbulimi, përmasat dhe kontrolli i Aflatoksinës”, ishte

projekti i nxënësve kosovarët që u renditën të tretë ndër 385 projekte pjesëmarrëse nga 66

vende të ndryshme të Botës dhe 44 shteteve të Amerikës. Qëllimi i këtij punimi ishte konstatimi i

prezencës së Aflatoxinës në paratë e letrës, si dhe sygjjerimi i zgjidhjeve të mundshme.

Aflatoksina njihet si një ndër substancat më kancerogjene, që shkaktojnë kancerin e mëlqisë.

Pavarësisht moshës fare të re, nxënësit e gjimnazit kanë shkëlqyer duke lënë të habitur jurinë me aftësitë e tyre në përgatitjen dhe zhvillimin e projektit. Nxënësit sot (10.05.2014) u kthyen nga garat me medaljet e tyre në qafë me plot nderë të përfaqësimit të denjë të shtetit të tyre në arenën ndërkombëtare. Ata u pritën në aeroportin e Prishtinës nga zyrtari i lartë i ministrisë së arsimit ztr.Osman Shahini, familjarët, shokët si dhe mësuesit e tyre.

Fondacioni për Arsim dhe Kulturë Atmosfera, vazhdon të promovojë arsimin në Kosovë.

Kualiteti i mësimit që nxënësit marrin në Gjimnazin Hasan Nahi themeluar nga Fondacioni

Atmosfera, iu mundëson nxënësve për të vazhduar studimet në cilindo universitet të botës, dhe

janë të gatshëm që të mund të garojnë në cilindo vend të botës.

Ju dëshirojmë atyre dhe shkollës edhe shumë suksese të tilla në të ardhmen./Indeksonline